



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) e LVL-së, nenit 4, shkronja f) dhe g) të UA 2005/2010 dhe nenit 37, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i Statutit të Komunës së Gjiçanit, për realizimin e kompetencave vetanake, pas Vendimit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, nr.AUV 01-207/2017 të datës 18.07.2017, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, në seancën e mbajtur me date 16.08.2017, miraton këtë :

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për nevoja të “ Groposjes së kafshëve të ngordhura” në Gjiçan

1. Kuvendi i Komunës **Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për nevoja të “Groposjes së kafshëve të ngordhura”, në ngastrën kadastrale:**

P-70403016-00708-2, lloji i njësisë : parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, sipërfaqja 2000 m², vendi i quajtur “Osoje”, lloji i shfrytëzimit të parcelës- rajon pyjor, shfrytëzimi aktual i parcelës – tokë pyjore, klasa e kualitetit – mal i klasit 5, pronar i parcelës : P.Sh. Kuvendi i Komunës Gjiçan, Zona Kadastrale Livoq i Epërm.

2. Lokacioni i përshkruar më lartë do të ketë destinimin për groposjen e kafshëve të ngordhura ashtu siç është kërkuar me Vendimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë të Republikës së Kosovës , AUV.nr.01-207/2017 të datës 18.07.2017.

6.Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjiçanit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë dhe Drejtoria e Bujqësisë, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjiçan.

7. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Nr.01.016-84833

Gjiçan, më 16.08.2017

Kryesuesi i KK-Gjiçan

/Shpresa KURTESHI/